



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije



Datë; 20/03/2012

KONKLUZIONE

nga

Këshillimi Publik i dokumentit

'Rregullore për të drejtën e shtegut dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës'

Bordi i ART-së në mbledhjen e XXVIII të radhës të mbajtur më datë; 15 dhe 17 Nëntor 2011, sipas procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Brendshme të ART-së, ka nxjerr aktvendimin Nr. 147 (Ref. ART. Nr. Prot. 063/B/11), për fillimin e këshillimit publik të **'Draft Rregullores për të drejtën e shtegut dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës'**, e cila është përgatitur nga Departamenti i Telekomunikacionit (D.T) me asistencën dhe mbikëqyrje profesionale të ekspertëve të Komisionit Evropian /TAIEX.

Draft Rregullorja për të drejtën në shteg dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës është publikuar në ueb faqen e ART-së (<http://www.art-ks.org/?cid=1,179>) dhe ka kaluar në këshillim publik me datat; **21 Nëntor 2011 deri me 20 Dhjetor 2011.**

Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj rregulloreje si dhe me qëllim të krijimit të një dokumenti sa më përmbajtjesor, ART gjate muajit Mars ka organizuar dëgjime publike me të gjitha palët e interesit.

Takimet me palët e interesit janë zhvilluar në datat si në vijim;

- Më datë; 07 Mars 2012, me fillim në ora 10:00 takim me operatorët, të cilët ofrojnë shërbime telekomunikuese në vend;
- Me datë; 08 Mars 2012, me fillim në ora 10:00 takim me përfaqësuesit e kuvendeve komunale, respektivisht drejtorive të urbanizmit
- Me datë; 09 Mars 2012, me fillim në ora 14:00 takim me përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike jo-telekomunikuese si; Hekurudhat e Kosovës, KOSTT, dhe Agjensioni i Pyjeve të Kosovës

Në tabelën në vijim janë dhënë komentet e dërguara nga operatori IPKO Telecommunications LLC (Ref. Shkresa e dërguar me datë; 20 dhjetor 2011) si dhe përgjigjet dhe konkluzionet e Bordit të ART-së në këto komente të dala nga shqyrtimi përmbyllës i administruar në mbledhjen e XXXIII të Bordit të ART-së.

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
1.	<p>1.1 E drejta për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës ekzistuese të operatorëve</p> <p>Draft Rregullorja në fjalë i referohet edhe shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës ekzistuese së operatorëve që ofrojnë shërbime telekomunikuese, dhe kjo e bën të njëjtën të paqartë, ngase shfrytëzimi i infrastrukturës së operatorëve telekomunikues është i rregulluar me rregullore të tjera të ART-së, siç janë Rregullorja për Analizën e Tregut, Rregullorja për Qasje, dhe rregullore të tjera të ART-së. Prandaj, IPKO kërkon që Neni 2 i draft Rregullores në fjalë të sqaroj se shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese të operatorëve telekomunikues nuk është objekt i rregullimit të kësaj draft Rregullore dhe që këto çështje janë të rregulluara në Rregulloret e përshkruara në paragrafin paraprak.</p>	<p>Rregullorja ka të bëjë me implementimin Direktivës Direktives; 2002/21/EC, respektivisht nenit 12, e amendamentuar me Direktiven; 2009/140/EC.</p> <p>Neni 12 i Direktives përcakton kornizën e përgjithshme për të drejten për shteg për kolokim dhe bashkeshfrytëzim të elementeve të rrjetit dhe paisjeve perçjellese për ofruesit e rrjetave të komunikimeve elektronike.</p> <p>Ne perputhje me kornizën rregullatore të përcaktuar me Nenin 12, E drejta për shteg si e tillë përfshinë servitutin, është e zbatueshme ndaj të gjithë personave që kanë në pronësi/kontrollojnë Infrastruktura, e cila është e pershtatshme për shtrirje të rrjetit të komunikimeve elektronike.</p> <p>E drejta për shteg ka zbatim simetrik dhe nuk interferon me kornizën për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), ku kemi një rregullim asimetrik dhe obligimet (mund të) të përcaktohen si masa të perkohshme për të adresuar deshtimet e definuara të tregut dhe zakonisht aplikohen ndaj një operatori.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
2.	<p>1.2 Pronësia mbi investimet e operatorëve në infrastrukturën alternative</p> <p>Rregullorja duhet të përcaktoj se investimet në infrastrukturën përkatëse publike të bëra nga operatorët telekomunikues, bazuar në Marrëveshje me pronarët e infrastrukturës, do të rregullohet me të njëjtën Marrëveshje, dhe nuk do të jetë objekt i rregullimit të kësaj Rregullore.</p>	<p>Neni 8, paragrafi (3) i Rregullores përcakton se:</p> <p><i>“Marrëveshja duhet të përfshijë kushtet teknike, komerciale dhe financiare si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve”.</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
3.	<p>1.3 Ndarja e infrastrukturës nacionale dhe asaj komunale</p> <p>Ligji për Rrugët në Kosovë e përcakton qartë definicionin për rrugët si dhe ndarjen e tyre duke përfshirë edhe kompetencat e institucioneve për të gjitha llojet e rrugëve.</p> <p>Andaj, kjo Rregullore duhet të përcaktoj qartë definicionin dhe institucionet të cilat janë kompetente për infrastrukturën nacionale si dhe komunale, duke u nisur nga ndarja që bën Ligji mbi Rrugët.</p>	<p>Dispozitat janë neutrale ndaj statusit juridik të pronarit të Infrastrukturës. Dispozitat e Rregullores janë të zbatueshme në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë pronarëve të Infrastrukturës.</p> <p>Për të qartësuar këtë është shtuar paragrafi (4) në Nenin 2:</p> <p><i>“Rregullorja zbatohet ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, duke përfshirë edhe ata publik që kanë në pronësi/kontrollojnë Infrastrukturën”</i></p> <p>Kjo Rregullore nuk ka për qëllim që të përcaktoj të gjithë pronaret e mundshëm të Infrastrukturës së shtrirë në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>Gjatë takimit të mbajtur me datë; 7 Mars 2012 operatorët deklaruan se është e vështirë të gjendet pronari i Infrastrukturës të cilën ata do të dëshironin ta bashke-shfrytëzojnë. ART dhe operatorët u pajtuan që kenë parasysh këtë problem si dhe të shikojnë për mundësinë e adresimit të përbashkët të problemit gjatë takimeve me institucionet tjera, përfshirë komunitat.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
4	<p>Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme</p> <p>Neni 1 i referohet pikës b) të Nenit 1 të Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, dhe në këtë ligj nuk ekziston një paragraf i tillë, prandaj kjo pjesë duhet të përmirësohet.</p>	<p>Neni 1 do të përmisohet si në vijim:</p> <p><i>“Në bazë të nenit 1, pika (1) dhe pika (2)”</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
5.	<p>Neni 3 - Definicionet</p> <p>IPKO propozon që të definohen edhe shprehjet si në vijim, meqenëse Rregullorja i referohet këtyre definicioneve nëpër tekst, ose duhet t’ju referohet:</p>	<p>-----</p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
5.1	<p>Pronarët e infrastrukturës publike/alternative;</p> <ul style="list-style-type: none"> - është entiteti publik /shtetëror i cili ka në menaxhim operimin si dhe investimet në infrastrukturën publike. 	<p>Është konsideruar si më e arsyeshme që ky term të mos elaborohet në definicion. Në secilin rast është e qartë se kush e ka në pronësi Infrastrukturën, por vetëm sa për te qartësuar Rregullorja zbatohet gjithashtu ndaj personave publik.</p> <p>Po ashtu është përfshirë paragrafi (4) në Nenin 2 duke elaboruar se " Rregullorja zbatohet ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, përfshirë personat publik që kanë në pronësi apo kontrollojnë Infrastrukturën".</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pjesërisht pranohet</u></p>
5.2	<p>Shfrytëzuesit e infrastrukturës së komunikimeve elektronike</p> <ul style="list-style-type: none"> - janë operatorët e komunikimeve elektronike, të licencuar nga ART për ofrimin e kësaj shërbimeve. <p>Koment: Rregullorja i referohet edhe shfrytëzuesit të infrastrukturës, edhe përdoruesit të infrastrukturës, prandaj është e nevojshme që të unifikohet Rregullorja në përdorimin e fjalës përdorim dhe shfrytëzim, ndërsa nëse ka dallim ligjor në mes të këtyre dy fjalëve të jepet definicioni.</p>	<p>Përdoruesit e infrastrukturës së komunikimeve elektronike janë operatorët prandaj kemi shtuar definicionin për Operatorët.</p> <p>Është përdorë definicioni si në vijim:</p> <p><i>"Operatorët - nënkupton një ndërmarrje/entitet ligjor që ofron ose që është i autorizuar të ofrojë rrjete të komunikimeve elektronike ose pasje shoqëruese."</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
5.3	<p>Marrëveshja - (te definohet)</p>	<p>Esenca e marrëveshjes është definuar në nenin 8, paragrafin (3) dhe si tillë përcakton:</p> <p><i>"... Marrëveshja duhet të përmbajë kushtet teknike, komerciale dhe financiare si dhe obligimet dhe përgjegjësit e palëve"</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pjesërisht pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
5.4	<p>Leja / Pëlqimi</p> <p>- është leje e veçantë që i ipet operatorëve për shfrytëzim të infrastrukturës alternative (publike). Bazuar ne Ligjin mbi Rrugët, gjegjësisht Nenet 27 dhe 28 të këtij Ligji, institucionet përkatëse për rrugët e caktuara lëshojnë pëlqime për shfrytëzim të infrastrukturës, pëlqim i cili përmban kushte të veçanta dhe mënyra e kompensimit të bazuara ne rregulloret e caktuara të po atij Institucioni (komunal apo nacional).</p> <p>Koment: Rregullorja duhet të qartësoj rastet kur operatorët mund të lidhin Marrëveshje me një pronar të infrastrukturës dhe kur do të aplikohen lëshimi i Lejes/Pëlqimit nga institucionet përkatëse.</p>	<p>Neni 7, paragrafi (3) i Rregullores është plotësuar, respektivisht është shtuar referenca për aktet tjera ligjore:</p> <p><i>“Procedurat dhe kushtet për bashkë-shfrytëzim të Infrastrukturës do të përcaktohen në Marrëveshje ose përmes procedurës dhe kushteve të përshkruara sipas akteteve ligjore.”</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pjesërisht pranohet</u></p>
5.5	<p>Personat e angazhuar në ndërtim të rrjeteve</p> <p>- IPKO propozon largimin e kësaj kategorie, ngase operatorët dhe pronarët e infrastrukturës duhet të jenë përgjegjës për publikimin e informacionin në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të infrastrukturës, sipas obligimit të paraparë në Nenin 4 (3) të draft Rregullores.</p>	<p>Dispozita e Nenit 4(3) është qartësuar si ne vijim:</p> <p><i>“Personi që ka urdhëruar shtrirjen e infrastrukturës, para se punimet e tilla të fillojnë, në përputhje me procedurën, kushtet dhe rastet e përcaktuara në aktet ligjore për instalimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, do të bëjnë publike informacionin në lidhje me fillimin e punimeve të shtrirjes dhe për mundësinë që personat tjerë të marrin pjesë bashkërisht në shtrirjen e përbashkët të rrjetit të komunikimeve elektronike.”</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
5.6	<p>Komentet në definicionet e përcaktuara në Rregullore:</p> <p>Ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike</p> <p>- të saktësohet se ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë entitete të cilat janë të autorizuar nga ART për të ofruar rrjete të komunikimeve elektronike, ose nëse nuk është fjala vetëm për këta operatorë, atëherë kjo të saktësohet në Rregullore.</p>	<p>Shih sqarimin e bërë për komentin 5.2.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
6.	<p>Neni 4</p> <p>Parimet Bazë për Instalimin e Infrastrukturës së komunikimeve elektronike</p> <p>Neni 4 (2) thotë: <i>“Zhvendosja e infrastrukturës, e bërë me rastin e ndërtimit ose rikonstruktimit të ndërtesave, urave dhe strukturave tjera, do të kryhet nga shfrytëzuesit e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në llogari të tyre sipas specifikimeve teknike të ofruara nga pronarët e infrastrukturës dhe pas koordinimit të punës së tillë me pronarët e lartpërmendur, përpos nëse shfrytëzuesit dhe pronarët nuk merren vesh ndryshe”</i></p> <p>Ky paragraf është në kundërshtim me Nenin 29 të Ligjit Nr. 2003/11 mbi Rugët, i cili përcakton që në rast se kërkohet largimi/zhvendosja e infrastrukturës, e cila është vendosur me procedura të rregullta te parapara me ligj, atëherë personi juridik apo fizik, që në rastin konkret është operatori i komunikimeve elektronike, ka të drejtë të kërkojë kompensim. Për më tepër, zhvendosja e infrastrukturës do të shkaktoj shpenzime të larta për operatorët e telekomunikimeve elektronike, prandaj kompensimi i tyre nga pronarët e infrastrukturës.</p>	<p>Paragrafi (2) i nenit 4 është riformuluar në këtë mënyrë:</p> <p><i>“Zhvendosja (re-location) e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, e bërë me rastin e ndërtimit ose rikonstruktimit të ndërtesave, urave dhe strukturave tjera, do të kryhet nga personat, të cilët kanë urdhëruar punimet e tilla për ndërtim/rikonstruktimit në llogari të tyre sipas specifikimeve teknike të ofruara nga pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe pas koordinimit të punës për zhvendosje me pronarët e lartpërmendur, përpos nëse personat që kanë urdhëruar punime të tilla për ndërtim/rikonstruktimit dhe pronarët e infrastrukturës së komunikimeve elektronike nuk janë marrë vesh ndryshe.”</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
7.	<p>Neni 4(3) parasheh: <i>“Personat e angazhuar në ndërtimin e rrjeteve, në përputhje me procedurën, kushtet dhe rastet e përcaktuara në aktet ligjore për instalimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e Infrastrukturës do të bëjnë publike informacionin në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit dhe për mundësinë që personat tjerë të marrin pjesë në ndërtimin e përbashkët të infrastrukturës.”</i></p> <p>Obligimi për të bërë publike informacionin në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të infrastrukturës duhet të jetë obligim i pronarit të infrastrukturës dhe jo i personave të angazhuar në ndërtimin e rrjeteve, ngase pronari mund të zgjedh që ndërtimi i rrjetit të bëhet nga ndonjë kontraktor, mirëpo përgjegjësitë që dalin nga kjo Rregullore duhet t'i takojnë vetëm atij/pronarit.</p>	<p>Formulimi i nenit është pershtatur/ndryshuar si ne vijim:</p> <p><i>“Personi që ka urdheruar shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike ...”</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
8.	<p>KAPITULLI III Shfrytëzimi i përbashkët i Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike</p> <p>Neni 7 - Kërkesat e përgjithshme</p> <p>Komentet i përgjithshme: - Neni 7 duhet të riemërohet në mënyrë që të kuptohet se fjala është për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës publike/alternative, dhe jo asaj ekzistuese të operatorëve telekomunikues, meqë shfrytëzimi i përbashkët i kësaj infrastrukturës është i rregulluar me Rregullore të veçanta të ART-se (shih komentin në piken 1.1 më lartë). - Në disa raste i referohet ofruesit të infrastrukturës, dhe në disa tjera pronarit të infrastrukturës. Kjo duhet të unifikohet në këtë Nen dhe në tërë Rregulloren.</p>	<p>Titulli i ri është si në vijim:</p> <p><i>“Shfrytëzimi i përbashkët i Infrastrukturës”</i></p> <p>Shih sqarimet shtesë të bëra në komentin 1.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pjesërisht pranohet</u></p>
9.	<p>Neni 7(2): <i>“Nëse një pronar ofrues i rrjeteve komunikuese publike/ alternative nuk mund ta realizojë të drejtën për të instaluar Infrastrukturën e nevojshme ose kostot e realizimit të së drejtës së tillë janë të larta në mënyrë jo-proporcionale, Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (tutje i njohur si – ART) mund të kërkojë nga ofruesit pronarët e rrjeteve ose nga personat tjerë që kontrollojnë infrastrukturën përkatëse që të lejojnë, në kushte jo-diskriminuese shfrytëzimin e përbashkët të</i></p>	<p>Artikulli është sqaruar dëgjimin publik të organizuar më datë; 07 Mars 2012.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
	<p>infrastrukturës ekzistuese si dhe të tubacioneve të tjera përkatëse, kanaleve kabllore, mbledhëse, kullave, shtyllave, ndërtesave dhe objekteve tjera ose instalimin e infrastrukturës, kur kjo kosto është e arsyeshme dhe nuk kërkon punë të konsiderueshme shtesë. Në këtë rast, ART do të konsultojë personat e interesuar, në përputhje me procedurat, afatet dhe kushtet e përcaktuara në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.”</p>	
10.	<p>Neni 7 (3): “Procedura dhe kushtet për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës duhet të përcaktohen në Marrëveshje;”</p> <p>Bazuar në Ligjin mbi Rrugët, gjegjësisht Nenet 27 dhe 28 të këtij Ligji, institucionet përkatëse për rrugët e caktuara lëshojnë pëlqime për shfrytëzim të infrastrukturës, pëlqim i cili përmban kushte të veçanta dhe mënyra e kompensimit të bazuara në rregulloret e caktuara të po atij Institucioni (komunal apo shtetëror).</p>	<p>Formulimi i Nenit 7(3) është ndryshuar/përshtatur si në vijim:</p> <p>“Procedura dhe kushtet për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës do të përcaktohen në Marrëveshje ose me procedurat dhe kushtet e përshkruara sipas akteve ligjore”</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
11.	<p>Neni 7 (4) duhet të ristrukturohet ngase është i paqartë në vetvete. Nuk është e qartë se cilat janë bazat për refuzim të kërkesës për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës.:</p> <p>“Pronari i Infrastrukturës nuk mund të refuzojë lidhjen e Marrëveshjes me shfrytëzuesin e infrastrukturës, ose nëse marrëveshja është lidhur nuk mund të kërkojë ndryshimin ose përfundimin e saj, në rastet e paraqitura në vijim:</p>	<p>Artikulli është sqaruar dëgjimin publik të organizuar më datë; 07 Mars 2012.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
12.	<p>4.1): kërkesa arsyetohet, d.m.th shfrytëzuesi i Infrastrukturës nuk është në gjendje ta ushtroj të drejtën e tij për të instaluar infrastrukturën e nevojshme ose në rast se shpenzimet për zbatimin e të drejtës së cekur janë jo-proporcionalisht të larta; kushti do të konsiderohet i paplotësueshëm, në rast të disponueshmërisë së mundësive të arsyetuara teknike dhe komerciale për shtrirjen e linjave tjera të reja të komunikimeve elektronike ose instalimin e pajisjeve dhe aparateve;</p>	<p>Artikulli është sqaruar dëgjimin publik të organizuar më datë; 07 Mars 2012.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
13.	<p>4.2) kjo është ekonomikisht e qëndrueshme dhe nuk kërkon asnjë punë thelbësore shtesë;</p>	<p>Artikulli është sqaruar dëgjimin publik të organizuar më datë; 07 Mars 2012.</p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
		<u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u>
14.	<p>4.3) kushti do të konsiderohet i paplotësueshëm në cilëndo nga rastet e cekura”:... Të shtohet 4.3 (f) ku do të parashihej se në rastet kur refuzohet kërkesa e operatorit për shfrytëzim të infrastrukturës alternative, pronari i infrastrukturës duhet t’i jap operatorit një alternative tjetër, në mënyrë që të bëjë të mundur shtrirjen e infrastrukturës së operatorit brenda territorit ku pronari e ka të shtirë infrastrukturën e tij.</p>	<p>është shtuar teksti në Nenin 7, paragrafin (6) si në vijim: “.....Kur kërkesa e operatorit refuzohet, pronari i infrastrukturës duhet që së bashku me përgjigjen negative t’i ofroj operatorit alternativat tjera të bashkë-shfrytëzimit të infrastrukturës së tij/saj aty ku një mundësi e tillë ekziston.” <u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
15.	<p>Neni 7 (6). Të shtohet fjalia: Në rast se pronari i infrastrukturës nuk i kthen përgjigje kërkesës së operatorit për shfrytëzimin e infrastrukturës alternative brenda afatit prej një (1) muaj nga dita e pranimit të kërkesës, atëherë heshtja e pronarit të infrastrukturës do të konsiderohet si heshtje administrative, gjegjësisht si pranim/miratim i kërkesës së operatorit.</p>	<p>Komenti nuk pranohet pasi që Pranimi/Refuzimi i kërkesës varet nga mundësitë teknike të bashkë-shfrytëzimit <u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
16.	<p>Neni 7 (12) Të shtohet obligimi në vijim për pronarët e infrastrukturës alternative: Në rast se shfrytëzuesit të infrastrukturës apo palëve të interesuara për çfarëdo arsye i ndalohej qasje në uebfaqen zyrtare ku pronari i infrastrukturës ka të publikuar informacionin në lidhje me infrastrukturën në dispozicion për shfrytëzim, atëherë shfrytëzuesi ka të drejtë të ankohet në ART për këtë. Të njëjtit, të paktën, brenda 5 ditëve nga dita e kërkesës, do t’i mundësohet qasja në kopjet fizike të informacioneve në fjalë.</p>	<p>Neni 7, paragrafi (12)/(ne versionin final rezultn si paragrafi 11) është ri-formuluar si në vijim: “Pronari i infrastrukturës, duhet t’i ofroj operatorit qasje elektronike në informatat mbi infrastrukturën e kontrolluar. Në rastet kur një informatë e tillë nuk mund të ofrohet në mënyrë elektronike, pronari i infrastrukturës duhet t’i ofroj operatorit kopjet fizike mbi informatat e kërkuara brenda afatit kohorë prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i pranimit të kërkesës. Pronari i infrastrukturës duhet të sigurojë se informatat mbi infrastrukturën e kontrolluar është e azhurnuar”. <u>KONKLuzion; Komenti pjesërisht pranohet</u></p>
17.	<p>Neni 8 - Procedura e arritjes së Marrëveshjes/Pëlqimit Neni 8 (2) parasheh: “Pronari i Infrastrukturës, jo më vonë se afati kohor prej një (1) muaji, nga data e parashtrimit të kërkesës, do t’i ofroj një përgjigje me shkrim shfrytëzuesit të infrastrukturës, i cili e ka paraqitur kërkesën. Marrëveshja duhet të arrihet jo më vonë se afati kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve një (1) muaji nga data e sigurimit të pëlqimit të pronarit të infrastrukturës, ose vendimit të ART-së për të lejuar përdorimin e infrastrukturës. Marrëveshja duhet të përshijë kushtet teknike, komerciale dhe financiare, si dhe detyrimet dhe</p>	<p>Sipas Neni 8(3); “Marrëveshja duhet të përmbajë kushtet teknike, komerciale dhe financiare si dhe detyrimet dhe përgjegjësit e palëve”. Është e pamundur të arrihet pajtueshmëri në kushtet teknike, komerciale dhe financiare duke aplikuar procedurat e heshtjes administrative. <u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
	<p><i>përgjegjësitë e palëve.”</i></p> <p>Të shtohet fjalia: Në rast se pronari i infrastrukturës nuk i kthen përgjigje kërkesës së operatorit për shfrytëzimin e infrastrukturës alternative brenda afatit prej një (1) muaj nga dita e pranimit të kërkesës, atëherë heshtja e pronarit të infrastrukturës do të konsiderohet si heshtje administrative, gjegjësisht si pranim/miratim i kërkesës së operatorit</p>	
18.	<p>Neni 9 - Kërkesat e detyrueshme, në lidhje me shfrytëzimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike</p> <p>Neni 9 (3) <i>“Pronari i infrastrukturës, infrastruktura e të cilat është përdorur nga shfrytëzuesi i kësaj Infrastruktura në përputhje me Marrëveshjen e arritur, do të:</i></p> <p><i>b) vendos një procedurë për regjistrimin e gabimeve, të cilat do të mund të regjistrohen pas mbikëqyrjes teknike të Infrastrukturës, në bazë të parametrave / specifikacioneve teknike të përcaktuar në Marrëveshje/Pelqim;</i></p> <p><i>c) kryej mbikëqyrjen teknike të Infrastrukturës, në bazë të parametrave/specifikacioneve teknike të përcaktuar në Marrëveshjen/Pëlqimin.”</i></p>	<p>Artikulli është sqaruar dëgjimin publik të organizuar më datë; 07 Mars 2012.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
19.	<p>Neni 10 Përgatitja e Projekteve</p> <p>10 (1) gabim teknik. Duhet te jetë: nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë Rregullore, në vend të: <i>“Në rast se nuk është parapare ndryshe me këtë Marrëveshje”</i></p>	<p>Nuk kemi të bëjmë me gabim teknik. Për më tepër teksti aktual nuk është në kundërshtim me tekstin e propozuar nga IPKO.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
20.	<p>Neni 11- Procedura e përcaktimit dhe pagesës së tarifës për përdorimin e Infrastrukturës së komunikimeve elektronike</p> <p><i>Neni 11 (2) parasheh se “Pronari i Infrastrukturës duhet të caktojë tarifën për përdorimin e Infrastrukturës. Në rast se palët dështojnë në arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me tarifën për përdorimin e Infrastrukturës, ART, gjatë zgjidhjes se konfliktit, ka të drejtë që të vendosë një tarifë të arsyeshme për përdorimin e Infrastrukturës, duke marrë në konsideratë.” ...</i></p>	<p>Dispozitat e Nenit 11(2) është ndryshuar si ne vijim:</p> <p><i>“Pronari i infrastrukturës duhet të caktojë tarifën për përdorimin e infrastrukturës duke marrë parasysh dispozitat relevante të përcaktuara me aktet ligjore...”</i></p> <p>Neni 23(1) i draft Ligjit zbatohet për Instalim, Mbrojtje, Bashkeshfrytëzim dhe Mirembajtje të Infrastruktures së Komunikimeve</p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
	<p>Draft Ligji për Komunikimet Elektronike në Kosovë parasheh që përdorimi i të drejtës në shteg dhe infrastrukturës publike do të bëhet pa pagesë. Në anën tjetër, rregulloret përkatëse të komunave të Kosovës kanë secila tarifën e tyre përkatëse për shfrytëzim të infrastrukturës, dhe këto tarifa janë fikse dhe nuk mund të jene objekt i negocimit në mes të pronarit të infrastrukturës dhe shfrytëzuesit të saj. Prandaj, këto duhet të sqarohen në këtë Rregullore me saktësi.</p>	<p>Elektronike vetem ne Sistemin Rrugor.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
21.	<p>Neni 11 (6): <i>“Në marrëveshje mund të parashihet e drejta e pronarit të Infrastrukturës për të rishikuar shumën e tarifës, në rast të ekzistimit të arsyes përkatëse ekonomike, por ndryshimet e tilla mund të bëhen jo më shpesh se një herë në një tri (3) vite. Në rast se e drejta e cekur është paraparë, pronari i infrastrukturës duhet t’ia paraqesë shfrytëzuesit të Infrastrukturës ndryshimet e planifikuara të shumës së tarifës dhe bazueshmerinë ekonomike të ndryshimeve të tilla, jo më vonë se tre nëntë (9) muaj para data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, në rast se nuk është paraparë ndryshe me Marrëveshje.”</i> Pronari i infrastrukturës nuk është i lejuar që të bëjë ndryshimin e çmimit të shfrytëzimit jo më shumë se +/- 10% të çmimit të tregut.</p> <p>Koment: Ndryshimi eventual i çmimit të shfrytëzimit të infrastrukturës duhet të bëhet sa më rrallë që është e mundur, duke marrë parasysh planifikimet buxhetore të operatorëve. Çmimet nuk duhet të ndryshohen në mënyrë drastike që të ndikojnë në vendimin e operatorëve që të heqin dorë nga shfrytëzimi i infrastrukturës përkatëse.</p>	<p>Ky paragraf është ndarë në dy paragrafe;</p> <p>(6) Në marrëveshje mund të parashihet e drejta e pronarit të infrastrukturës për të rishikuar shumën e tarifës, në rast të ekzistimit të arsyes përkatëse ekonomike, por ndryshimet e tilla mund të bëhen sa më rrallë që e mundshme. Tarifat nuk duhet të ndryshohen në mënyrë drastike dhe të afektojnë (ndikojnë) në vendimin e operatorëve për të braktisur përdorimin e infrastrukturës.</p> <p>(7) Në rast se e drejta e cekur është paraparë, pronari i infrastrukturës duhet t’ia paraqesë operatorit ndryshimet e planifikuara të shumës së tarifës dhe bazueshmerinë ekonomike të ndryshimeve të tilla, jo më vonë se tre (3) muaj para data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, në rast se nuk është paraparë ndryshe me Marrëveshje.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
22.	<p>Neni 11 (7). Gabim teknik. Duhet të jetë kushteve të parapara në Nenin 11 të Rregullores</p>	<p>Referenca është amendamentuar në paragrafin 6 të Nenit 11.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>
23.	<p>Neni 12 - Kushtet e hyrjes fuqi, ndryshimi dhe përfundimi i marrëveshjes</p> <p>Neni 12 (3) parasheh: <i>“Njëra palë do të njoftojë palën tjetër për qëllimin e saj për ta përfunduar Marrëveshjen jo më vonë se një dy vite para datës së planifikuar të përfundimit, në rast se nuk është</i></p>	<p>Permbajtja është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>“Pronari i infrastrukturës do të njoftojë palën tjetër për qëllimin e saj për ta përfunduar Marrëveshjen jo më vonë se dy (2) vite para datës së planifikuar të përfundimit, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në Marrëveshje ose në këtë Rregullore dhe në rast se Marrëveshje është planifikuar të ndërpritet jo për</i></p>

Nr.	Komentet e IPKO-s	Përgjigjet e ART-së
	<p><i>parashikuar ndryshe në Marrëveshje ose në këtë Rregullore dhe në rast se Marrëveshje është planifikuar të ndërpritet jo për shkak të ndonjë shkelje thelbësore të saj."</i></p> <p>Koment: afati kohor duhet të jetë më i gjatë ngase operatorët duhet të jenë në gjendje të planifikojnë gjetjen e rrugëve alternative në mungesë të mundësisë për shfrytëzimin e infrastrukturës përkatëse. Për më tepër kjo Rregullore duhet të specifikoj të gjitha kushtet për shkëputjen e saj, në mënyrë që pronari i infrastrukturës të mos ketë hapësirë për ndërprerje të saj pa bazë ligjore.</p>	<p><i>shkak të ndonjë shkelje thelbësore të saj"</i></p> <p>Ky kapitull përfshinë rastet kur palët pajtohen mbi përdorimin e Infrastrukturës ne baza komerciale.</p> <p>Ne rast te mungesës se mundësive për përdorim te infrastrukturës mund te aplikohet Nenit 6 (Servitute)</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pjesërisht pranohet</u></p>
24.	<p>Neni 13 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve</p> <p>Të specifikohet që vendimet e ART-se janë objekt i ankimit sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë. I njëjti nen duhet të parasheh të drejtën e operatorëve që t'i drejtohen edhe gjykatës për të fituar të drejtat e tyre.</p>	<p>Procedura e rishikimit te vendimeve te ART është subjekt i draft Ligjit të ri për komunikime elektronike.</p> <p>Neni 87(18) ne draft Ligj: <i>"Vendimi i lëshuar nga Autoriteti ku konflikti është zgjidhur në esence ose konsiderimi i tij është ndërprerë ai mund te ankimohet ne Gjykate Brenda tridhjetete (30) ditëve nga data e hyrjes ne fuqi."</i></p> <p><u>KONKLuzion; Komenti nuk pranohet</u></p>
25.	<p>Neni 14 - Lirimi nga Përgjegjësia</p> <p>Ky Nen është plotësisht i paqartë. Nuk kuptohet qëllimi i të njëjtit. Duhet të sqarohet dhe të specifikohet mirë.</p>	<p>Neni eshte fshire. Faktet si ne vijim: Kjo eshte pyetje e normes legale ne pergjithesi. Ky Nen nuk percakton ndonje obligim ose dispozite te re.</p> <p><u>KONKLuzion; Komenti pranohet</u></p>